



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Shqyrtimi dhe votimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” dhe paketës fiskale (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Fadil Nasufi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Enkeleda Kuçi – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë

Jonida Kaza – specialiste në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë

Gentian Opre – drejtor Buxheti në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi - Përshëndetje!

Në fillim të mbledhjes së sotme do të kemi një informacion të shkurtër në lidhje me diskutimet, konkluzionet që kemi nxjerrë dhe çfarë iniciativash do të mbështesim.

A jeni dakord me procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Dakord.

Atëherë, kemi mbështetur kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë për një shtesë fondi prej 100 milionë lekësh për financimin e brendshëm për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural për vitin 2019, si edhe një shtesë fondesh prej 100 milionë lekësh për financimin e brendshëm për programin për sigurinë ushqimore. Nëse është e pamundur të gjenden këto fonde shtesë ne i kemi kërkuar që për të dyja këto pika të bëhet një rialokim fondesh duke i marrë nga ndihma mbështetëse për fermerët. AZHBR-ja gjatë vitit 2019 gjendet para një sfide, tashmë kemi një portofol shumë herë më të madh dhe nuk mund të lejojmë tkurrjen e institucionit, por kërkojmë forcimin e institucionit.

Imputet bujqësore kanë qenë një pikë shumë e debatueshme dhe është kërkuar heqja e tvsh-së për to, ndërkohë që propozimi ishte nga 0% deri në 6%. Do të mbështesim propozimin prej 6% të imputeve bujqësore. Gjithashtu, do të kërkojmë ndërtimin e sistemit të gjurmueshmërisë *trace&treis*. Ne e konsiderojmë të domosdoshëm implementimin e këtij sistemi.

Pra, besoj do të jetë një lajm i mirë për sektorin e bujqësisë ulja në mënyrë të ndjeshme e tvsh-së së imputeve bujqësore nga 20% në 6%. Pas bisedave me grupet e interesit, kemi arritur këtë përfundim: uljen e imputeve nga 20% në 6%. A jemi në rregull? Beteja ishte për zero, në fakt, por 6% është në rregull.

Sa i përket akcizës për zhavorrin bituminoz, ne kemi konsoliduar bindjen që, pavarësisht se ligji i akcizave imponon për të gjitha lëndët djegëse, masa e kërkuar dhe e sjell në paketën fiskale, e cila me uljen nga 2 në 1 lekë për kilogram përbën rreth 32% të çmimit të produktit, vazhdon të jetë e lartë. Ne propozojmë që akciza për zhavorrin bituminoz të ulet në vlerën nga 0,3, maksimumi në 0,5 lekë për kilogram. Ne duam ta çojmë në 15-20 që është pranueshme për kompanitë, por është një pikë ku ne po insistojmë fort për 0,3, 0,4, maksimumi

0,5. Kjo është renta e kromit. Kemi rënë dakord në parim që të stimulojmë përpunimin e kromit në vend. Kjo ka qenë logjika, sepse qeveria ka sjellë propozimin që për eksportin bruto të jetë 6%, ndërkohë që për të përpunuarin 9%.

Duke marrë në konsideratë ndryshimin e menjëhershëm, duke marrë në konsideratë mungesën e kapaciteteve për të përpunuar të gjithë kromin që nxirret në vend, duke marrë në konsideratë që kemi sot tri fabrika të përpunimit, duke marrë në konsideratë edhe paparashikueshmërinë e politikave fiskale për biznesin, që ka qenë një pikë e kritikuar për vite në Shqipëri dhe për të nxitur investimet në vend, ne kemi dalë me një propozim të ri: renta të shkojë në 9%, por të ndahet sipas viteve, 7%, 8% dhe 9%, respektivisht në vitin 2019, 2020, 2021, gjë që pas diskutimeve duket e pranueshme edhe për biznesin. Pra, i japim një fazë përgatitjeje të gjithë atyre që importojnë dhe eksportojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sugjerimi është që çështja e ndryshimeve në politikat fiskale duhet të ngrijë në një moment, sepse problematika e ndryshimit të shpeshtë ka qenë dhe mbetet. Këtë vit dhe vitet në vijim do të kemi një konsolidim të ndryshimeve për të mos pasur ndryshime të tjera.

Rakip Suli – Ndërhyrja e shpeshtë në paketat fiskale nuk jep impakt pozitiv as te pjesa e biznesit, sepse, nëse fillohet me këto rregulla loje, por ti ia ndryshon rregullat në mes të lojës, jep impakt negativ tek investitorët e huaj. Pjesa më negative e opozitës, kur ishte pjesë e qeverisë, ka ndërhyrë mbi 50 herë në paketën fiskale dhe asnjëherë nuk pati stabilitet në pjesën e garancisë së biznesit. Ne nuk jemi komision përgjegjës për këto, sepse është Komisioni i Ekonomisë, por unë mendoj se duhet të vijë momenti që t'u themi stop ndryshimeve të rregullave të lojës.

Kam edhe diçka tjetër për të thënë, ditën e djeshme kam ndërruar komplet mendimin nën dritën e disa fakteve të reja. Ju e dini që është propozuar një taksë për ambalazhin për plastikën. Kemi pasur një tarifë prej 100 lekësh për kilogram, ndërkohë që propozimi në paketën e re fiskale nga 100 lekë shkon në 35 lekë, ndërsa për lëndën e parë nga 0 shkon në 25 lekë.

Pra, nëse deri sot produktet e sjella nga importi kishin një fletë prej 100 lekësh për kilogram, ndërkohë që nuk ndryshon lëndë e parë, sot kemi zvogëlimin me 35 lekë për produktin dhe 25 lekë për lëndën e parë. Unë do t'ju inkurajoja të gjithëve që sot të kontaktojmë biznese të tilla të kërkojmë informacion, sepse dje më kanë rënë disa kambana alarmi dhe pasojat mund të jenë shumë të mëdha për prodhimin vendas. Pretendohet që mund të jenë 240, 250

biznese që afektohen nga një nismë e tillë dhe janë biznese që sjellin nga importi lëndë të parë dhe përpunojnë tuba, qese, shishe, kanë investuar në fabrika. Mua më kanë dërguar mesazhe edhe përfaqësuesit e disa fabrikave të reja që janë duke u instaluar në Shqipëri, të cilat një masë e tillë i penalizon. Pra, stimulohet importi, ndërkohë që penalizohet, sipas informacionit, prodhuesi vendas. Unë i kam kërkuar Ministrisë së Financave të dhëna për bizneset e kësaj fushe dhe të na bëjnë një parashikueshmëri të pasojave që do të prodhojë një masë e tillë. Deri para disa ditësh nuk është se e kam kuptuar mirë pasojën, ndërkohë nga dje më janë ndezur sinjalet e alarmit dhe do t'ju lutesha që secili prej jush me mënyrat e tij nëpër zonat elektorale ta testojë një gjë të tillë.

Ju e dini që në kontekstin e globalizimit, kontekstin e firmosjes së marrëveshjeve të tregtisë, gjithashtu, Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, barrierat ndërmjet vendeve vijnë duke u shuar, por ka një gradualitet në marrjen e vendimeve që impaktojnë prodhuesit vendas. Unë sot nuk di të them nëse janë 10, apo 20 apo 200 biznese, por di një duzinë deri sot, të cilat kanë blerë dhe bazuar në legjislacionin e kaluar po investojnë. Një pjesë kanë investuar dhe impaktohen konsiderueshëm aq sa disa prej tyre më thonë se do ta shihni se në 1, ose 2 ose 3 muaj jemi jashtë biznesit.

Kjo është çështja që duhet të reflektojmë gjatë këtyre ditëve edhe me qeverinë. Kemi vënë në dijeni edhe Ministrinë e Financave.

Besnik Baraj – Për ta konkretizuar, dje takuam një përfaqësues të biznesit, shembulli që më sollën është ky: nga importi vijnë tuba të gatshëm ose që quhen pipeta, që përdoren për ambalazh, këto vinin me një kosto 100 lekë për kilogram, tani u bë 35, në një kohë që granulat vinin me 0 lekë. Kjo ishte një lloj barriere, pavarësisht se formalisht ishte një taksë mjedisore, por ishte një lloj barriere që ndihmonte biznesin vendas që granulat t'i përpunonte këtu dhe të krijonte një produkt të gatshëm, sipas asaj filozofie që tha zoti Shalsi për kromin.

Pra, nëse ne jemi parimisht ekuivalent, pavarësisht nga produkti që prodhohet, ne duhet të stimulojmë gjenerimin e produkteve brenda vendit për shkak të fuqisë punëtore. Por çfarë ndodh? Nëse tubat vijnë me vlerë 35 lekë për kilogram dhe granulat që ishin 0, bëhen 25, kjo barrierë zvogëlohet shumë. Problemi është që tubat prodhohen kryesisht në pjesën veriore, në Serbi, ku energjinë biznesi e ka më të lirë, pra kjo bën që produkti i krijuar nga ata ishte aq i lirë saqë, pavarësisht se këtu vjen me 10 lekë më shtrenjtë se granula, prapëseprapë çmimi i tyre ishte më kompetitiv dhe i nxjerr jashtë loje të gjitha këto ndërmarrje, të cilat do të gjeneronin këto tuba në Shqipëri. Pyetja që i bëmë ne ishte: sa tuba marrim nga importi dhe sa nga granulat

gjenerojnë tuba? Sipas tij, ishte në raportin 1 me 7 që do të thotë 7 penalizohen dhe favorizohet 1. Kjo pa dyshim është një problematikë, për shembull karrigia që vjen nga importi nuk ka ndonjë tarifë në lidhje me materialet plastike që ka vetë karrigia e veshur, ndërkaj nga granula këtu gjenerohen pjesë që bëhen për karriget, mbështetëset, këmbët. Këto janë kosto që e bëjnë jo kompetitiv prodhimin vendas për shkak të këtyre shtesave që u bëhen këtyre produkteve në raport me ato që vijnë nga importi dhe që pjesët plastike nuk janë të tarifuara.

Eduard Shalsi – Kemi të pranishme zonjën Enkelejda Kuçi, përgjegjëse sektori, zonjën Jonida Kaza dhe zoti Gentjan Opre.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Vullnet Sinaj- Së pari, kryetar, ju falënderoj për këtë qëndrim pozitiv që mbani ndaj biznesit, sidomos prodhimeve vendase për të cilat edhe unë jam i bindur që është e vetmja rrugë që mund t'i japë ekonomisë sonë një zhvillim të qëndrueshëm, por unë nuk dëgjova të flitej për problemin e akcizës për fishekzjarrët. Ne kemi qenë kundër heqjes së kësaj akcize. Unë nuk do ta mbështes heqjen e akcizës së fishekzjarrëve, llambave. Mua nuk më duket një gjë normale. Fishekzjarrët janë mall qejfi, luksi, unë e di që normat e fitimit të tyre janë shumë të larta, janë 3-4 fish më të larta, kështu që nuk kemi pse t'u heqim akcizën. Nëse shtojmë buxhetin e shtetit, le t'u vijmë në ndihmë fermerëve, por jo t'u krijojmë këto vështirësi Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Për pilat dhe llambat mund të diskutohet.

Sa i përket rentës minerare, për të cilën diskutoam, në Shqipëri ka një kontradiktë të madhe. Vendet ku del nafta dhe mineralet janë vendet më të prapambetura, të pazhvilluara, nuk ka rrugë, nuk ka ujësjellës dhe kjo vjen për arsye se shumë pak nga renta minerare kthehet në qeverisjen vendore, në bashki, ose në njësitë administrative.

Te zona ime zgjedhore, zona naftëmbajtëse e Gorishtit, po të shkosh, mund ta shikosh me sy si është katandisur ajo zonë, e cila nuk ka përfituar ndonjëherë. Do të propozoja në këtë komision që të rritet vlera e rentës minerare që kthehet në njësitë vendore dhe administrative të këtyre zonave për të pasur mundësi investimi më shumë në rrugë dhe ujësjellës. Meqenëse jeni në prag të diskutimit të buxhetit, do të propozoja që të rritet, sepse në ligjin nr. 9975, të vitit 2008, thuhet që vetëm 5 % e kësaj rente kthehet në zonat ku shfrytëzohen minierat ose burimet e naftës. Kjo është shumë pak, sipas mendimit tim duhet të jetë deri në 50%, po të ishte e mundur, që kjo pjesë e lëndës të kthehet për të investuar në ato zona, sepse të paktën që kur

shfrytëzohet nafta në Gorishtë nuk ka një rrugë, nuk ka një ujësjellës, në Selenicë e njëjta gjë, madje unë them të na rrojë emri i bitumit të Selenicës, por asnjë investim nuk është bërë atje.

Besnik Baraj – Në fakt, nuk arrij të kuptoj realisht cili është motivi, argumenti që është hequr akciza për fishekzjarrët. Në shumë vende të botës janë të ndaluara për shkak të rrezikut që paraqesin për fëmijët dhe për ata që i përdorin, por mbi të gjitha për ndotjen. Ndotja veçanërisht në qytetet e mëdha, ku ato lëshohen në sasi të pakontrolluara, është e jashtëzakonshme. Pak vite më parë deputetëve të forcës sonë politike u kam nisur një material ku tregohet në mënyrë shkencore, të argumentuar, nga të tjerët jo nga unë, që efekti në shëndet është jashtëzakonisht i rëndë.

Vullnet Sinaj - Edhe për bateritë është e njëjta gjë, e ndotin ambientin. Kështu që pjesa e akcizës që mund të merret mund të shkojë te Ministria e Mjedisit për të ndihmuar në përmirësimin e mjedisit.

Besnik Baraj – Bateritë futen te lëndët e rrezikshme dhe gjithmonë kanë kosto shumë të madhe për depozitimin, kështu që është e pajustificuar.

Gentjan Opre - Propozimi është për autobusët elektrikë.

Besnik Baraj –Në fakt, duhet një interval kohe për t'i zëvendësuar, sepse është një kosto shumë e madhe për një taksixhi, që të blejë taksi elektrike. Po që se ne do të ecim me këto ritme në fushën e mjedisit, do e uroja me gjithë shpirt, por kam frikë mos ia kalojmë Gjermanisë dhe Francës.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Për kompanitë po, por për individët unë do të isha i rezervuar.

Eduard Shalsi- A keni ndonjë koment për të bërë?

Enkeleda Kuçi – Po ne i mbajmë shënim.

Eduard Shalsi - Në rregull, veç kini një gjë parasysh, kemi diskutuar edhe me përfaqësues të tjerë, dje edhe me ministrin në fakt, sa i përket zhavorrit bituminoz pranuar logjikën që duhet të kemi një akcizë, e imponon ligji, por në krahasim me koksit, fuqia kalorifike e të cilit është 90%, ndërsa e zhavorrit bituminoz është 20 %, rritja ishte proporcionale, plus që ishte një kosto shumë e rënduar.

Po kështu vetëm për pjesën e plastikës duhet një analizë e mirëfilltë. Nëse 20% e të dhënave që na dhanë dje janë të vërteta, atëherë jemi për t'u rënë kambanave të alarmit. Pra, impakti në industrinë e prodhimit të punimit të plastikës do të jetë i konsiderueshëm dhe nuk

është ky besoj qëllimi i projektligjit, kështu që duhen nxjerrë sa biznese operojnë në këtë fushë, sa punëtorë kanë, për ç'masa investimi flasim. Unë kam fotot e 3-4 bizneseve, të cilat po instalojnë makineri tani. Pra, sa është masa e investimeve për të llogaritur një produkt dhe nëse synojmë të fuqizojmë importin në kurriz të prodhuesve të vendit.

Besnik Baraj – Ne lidhje me atë që përmendëm 25 lekë apo 35 lekë, ne si komision, nuk jemi shprehur qartë për qëndrimin tonë. Ne do të investigojmë edhe 2 ditë dhe do të japim qëndrimin tonë.

Së dyti, në lidhje me atë që për çdo ton të grumbulluar të jetë 10 mijë lekë të rinj, me qëllim për të stimuluar grumbullimin, a është përcjellë?

Eduard Shalsi – Po, është përcjellë, kemi mbajtur shënim.

Nesër do të vijojmë me kandidaturat të Entit Rregullator të Energjisë. Kemi hapur një garë para disa muajsh, e cila nuk u arrit të kurorëzohej. Sot kemi 2 kandidatura të tjera, të cilat do t'i dëgjojmë nesër.

Mbetemi në kontakt, brenda ditës së premte duhet të hartojmë raportin përfundimtar për buxhetin.

E votojmë sot në parim buxhetin?

Atëherë, kush është pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me paketën fiskale, me ligjin e akcizës?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me paketën për TVSH-në?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me ligjin për taksat kombëtare?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me ligjin për taksat vendore?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Te diskutimi nen për nen do të bëjmë propozimet përkatëse.
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA